

Çështja e mbarështrimit dhe e përfundimit jo të drejtë të njësive sintaksore-kumtuese në faqet e shtypit tonë

Mr. Agim Spahiu

17 maj 2003

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori ka vënë në dukje tri raste, nga numri i madh i tyre, të mbarështrimit dhe të përfundimit jo të drejtë të njësive sintaksore-kumtuese në faqet e shtypit tonë.

Në faqet e shtypit tonë të përditshëm shpeshherë në kohë të fundit na kanë rënë në sy shumë ndërtime sintaksore të pambarështruara drejt nga aspekti gramatikor. Këtu do të ndalemi në tri raste si gabime më të rënda të cilat po i bëjnë artikullshkruesit tanë:

1. **Kur njësia sintaksore - kumtuese nis, po e zëmë, me një fjali të nënrenditur (p. sh. lejore), por ajo, për shkak të ekzagjerimit të tepruar me fjali të tjera, po ashtu, të nënrenditura, (sidomos me fjali përcaktore lidhore e lidhëzore etj.), nuk arrihet të përfundohet me një fjali tjetër të nevojshme drejtuese a kryesore. Dhe kjo gjë bën që e tërë fjalia e përbërë a periudha të mbetet pezull edhe nga aspekti kuptimor.**

Shembull: Ndonëse sot krijimtarinë e pavarur figurative e determinojnë ndikime nga shumë segmente të dinamikës së zhvillimit të shpejtë të teknikës e shkencës në përgjithësi, e me këtë kjo lëvizje ekspresive me ndikim të karakterit ekspresiv gjithsesi është evidente edhe në krijimtarinë artistike e posaçërisht në artet pamore/Bota sot, dt. 7.5.2003.f.21./.

2. **Kur një fjali kryesore a drejtuese ka nevojë të shpjegohet a të shtjellohet më tutje nga një fjali të nënrenditur ffilluese (p. sh. kryefjalore), por kjo nuk bëhet, ngase artikullshkruesi ndërhyt menjëherë me një fjali tjetër rrethanore (p. sh. lejore), pastaj e vazhdon rrëfimin dhe shpjegimin duke varguar disa fjali të tjera, madje edhe ffilluese (si p. sh. ndonjë fjali përcaktore - lidhore) dhe kështu e humb fillin e nuk arrin ta përfundojë fjalinë e nevojshme ffilluese..**

Shembull: *Mirëpo dihet mirëfilli se edhe pse piktura sot po ndeshet me trendet projektuese përmes fragmenteve instalative, gjegjësisht me të ashtuquajturën krijimtarinë instalative, që shpreh idenë e caktuar me inkorporimin e mjeteve të gatshme të cilat në disa korelacione kompozicionale i humb karakteri i organizimit të tërësishtëm brenda kornizave të realizimit. (Po aty në vazhdimësi nga i njëjti tekst f.f.21.).*

3. **Kur fjalia kryesore nis me përemrin dëftor - kjo, por aty për aty artikullshkruesi ndërhyr për të sqaruar diçka me një fjali të nënrenditur shkaktore, duke mos e vrarë mendjen fare se fjalia kryesore me këtë përemër si kryefjalë e fjalisë ka mbetur krejtësisht pezull si nga ana kuptimore, po ashtu edhe nga ajo gramatikore, sepse nuk përfundohet.**

Pra, në vend që të thuhet: *Kjo ndodhi kështu, sepse... ; ne po ndeshim vazhdimisht ndërtime të tipit, si: Kjo sepse imazhi i ri prej njerëzish të rënë në ujdi fshih mjaft enigma disa prej të cilave janë të imagjinueshme, disa të tjera të destinuara për të mbetur përjetësisht të padëshirueshme, e disa... . etj/**Bota sot**, dt.12.05.2002, f. 9/ .*